



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BURIMEVE NJËRËZORE DHE SHËRBIMEVE TË
BRENDSHME

Nr. 7464 Prot

Divjakë, më 18.07/2025

LËNDA: PROJEKT PËR KONSULTIM PUBLIK

**“MBI DISKUTIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2025–2030”
BASHKIA DIVJAKË**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 54, shkronja “k” dhe neni 18, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 20.03.2019 “Për miratimin e Rregullores së Njësive të Qeverisjes Vendore”, të Udhëzimit të MASR nr. 15, datë 15.05.2022 “Për përfshirjen e aktorëve vendorë dhe transparencën në hartimin e planeve të arsimit”, të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, dhe të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Divjakë nr.174, datë 29.05.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2025–2030”.

**Ju paraqesim për konsultim publik: “Planin e Arsimit Parauniversitar 2025–2030”
për Bashkinë Divjakë**

QËLLIMI I PLANIT

Të orientojë zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Divjakë, në përputhje me nevojat lokale dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të edukimit.

MISIONI

Të garantojë që çdo fëmijë të ketë mundësi për të ndjekur një arsimim të barabartë dhe të sigurt, duke përmirësuar infrastrukturën, rritur cilësinë e mësimdhënies dhe përforcuar bashkëpunimin me komunitetin për një sistem arsimor të drejtë dhe efikas.



OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Përmirësimi i strukturës menaxheriale dhe shërbimeve në arsim.
2. Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës shkollore dhe parashkollore.
3. Sigurimi i gjithëpërfshirjes dhe ulja e braktisjes shkollore.
4. Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse për nxënësit dhe mësuesit.
5. Fuqizimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe aktorët lokalë.
6. Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemit të të dhënave arsimore.

MASAT KRYESORE STRATEGJIKE

1. Përmirësimi i strukturës menaxheriale:

- Trajnime për drejtuesit e shkollave mbi leadershipin dhe menaxhimin efektiv.
- Digjitalizimi i sistemit të raportimit dhe të dhënave.
- Krijimi i grupeve ndërinstitucionale për bashkëpunim me sektorët e shëndetësisë dhe shërbimeve sociale.

2. Përmirësimi i infrastrukturës:

- Rikonstrukcion i kopshteve dhe shkollave në gjendje të amortizuar.
- Pajisja me laboratorë, kabinete, dhe mjete teknologjike moderne.
- Krijimi i ambienteve të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

3. Rritja e gjithëpërfshirjes:

- Fushata ndërgjegjësuese për regjistrimin në arsimin parashkollor dhe bazë.
- Identifikimi i fëmijëve që janë jashtë sistemit shkollor.
- Mbështetje financiare për fëmijët nga familje në nevojë.

4. Shërbime mbështetëse:

- Angazhimi i psikologëve dhe logopedëve në shkollat me mbi 50 nxënës.
- Zhvillimi i këndeve zhvillimore dhe sportivo-kulturore në institucione.
- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit dhe edukatorët.

5. Përfshirja e komunitetit:

- Takime të rregullta me prindërit dhe komunitetin shkollor.
- Aktivizimi i këshillave të shkollës dhe strukturave prindërore.
- Bashkëpunim me OJF-të dhe partnerët për projekte të përbashkëta.

JURISTI

Andi BULLARI



SPECIALISTE ARSIMI

Neroida NDONI



KRYETARI

Josif GORREA





Bashkia Divjakë

**Plani i Arsimit
Parauniversitar**

Përmbajtja

1.	Hyrje dhe konteksti.....	4
1.1	Profili demografik dhe social.....	4
1.2	Kuadri ligjor dhe kompetencat e Bashkisë në Arsim.....	4
2.	Përmbledhje Ekzekutive	5
2.1	Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar.....	5
	Prioritetet kryesore.....	5
2.2	Përmbledhje e strukturës dhe aktiviteteve të planit.....	6
3.	Analiza e shërbimit të arsimit parauniversitar	6
3.1	Arsimi parashkollor	6
3.2	Arsimi bazë	9
3.3	Arsimi i mesëm i përgjithshëm.....	13
4.	Përfshirja e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimi Psiko-Social	14
5.	Qendra Kulturore e Fëmijëve – Strukturë Mbështetëse Jashtëkurrikulare.....	16
5.1	Qëllimi, Misioni dhe Objektivat	16
5.2	Kalendari i aktiviteteve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve 2024–2025.....	17
6.	Objektivat dhe masat strategjike	17
6.1	Objektivat e përgjithshme	17
6.2	Masat strategjike	18
7.	Planifikimi i Burimeve Financiare	19
7.1	Burimet financiare vendore.....	19
7.2	Burime financimi të tjera	20
7.3	Klasifikimi i burimeve sipas natyrës.....	20
8.	Aktivitete dhe planifikimi i zbatimit	21
8.1	Aktivitetet sipas Fushave Arsimore	21
8.2	Afatet e Zbatimit.....	22
8.3	Roli i Aktorëve të Përfshirë	22
8.4	Detajimi i Shpenzimeve dhe Burimet Financiare	23

9.	Përmbledhje e investimeve kapitale.....	23
10.	Monitorimi dhe Vlerësimi.....	27
10.1	Indikatorët e Matshëm të Performancës.....	27
10.2	Planifikimi i vlerësimit të progresit	29
10.3	Mekanizmat konkretë për monitorim përfshijnë.....	29
10.4	Përfshirja e aktorëve të jashtëm	29
11.	Rishikimi dhe Përshtatja e Planit	29
11.1	Procesi i rishikimit	29
11.2	Përshtatja në bazë të të dhënave të reja.....	30
12.	Raportimi dhe transparenca	30
12.1	Raportimi i progresit	30
12.2	Përfshirja e publikut.....	31
	Anekse:.....	31

1. Hyrje dhe konteksti

1.1 Profili demografik dhe social

Pozicioni gjeografik: Bashkia Divjakë ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, brenda territorit të Qarkut Fier dhe kufizohet në veri me Bashkinë Rogozhinë, në lindje me Bashkinë Lushnje, në jug me Bashkinë Fier dhe në perëndim me detin Adriatik.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2023, Bashkia e Divjakës ka një popullsi prej 24,882 banorësh, ku 50.6% janë meshkuj dhe 49.4% janë femra. Kjo popullsi është e shpërndarë në pesë njësi administrative: Divjakë, Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas.

Të gjitha këto njësi janë pjesë e Qarkut Fier. Bashkia Divjakë përfshin një qytet dhe 39 fshatra në administrim.

Struktura Demografike: Sipas të dhënave të Censurit 2023, popullsia e Bashkisë Divjakë në grupmoshën 0–19 vjeç përbëhet nga:

- 0–4 vjeç: 1,086 fëmijë (549 meshkuj dhe 537 femra)
- 5–9 vjeç: 1,197 fëmijë (632 meshkuj dhe 565 femra)
- 10–14 vjeç: 1,375 fëmijë (736 meshkuj dhe 639 femra)
- 15–19 vjeç: 1,342 të rinj (694 meshkuj dhe 648 femra)

Në total, grupmosha 0–19 vjeç përbën një përqindje të konsiderueshme të popullsisë, çka reflekton rëndësinë e planifikimit arsimor dhe shërbimeve mbështetëse për këtë kategori. Emigracioni i lartë vijon të ndikojë në uljen e numrit të nxënësve, veçanërisht në zonat rurale. Rreth 19% e popullsisë janë fëmijë dhe të rinj të moshës 0–18 vjeç. Emigracioni i lartë ka ndikuar në uljen e numrit të nxënësve, veçanërisht në zonat rurale.

Arsimi: Në Bashkinë Divjakë funksionojnë 32 kopshte, 11 shkolla 9-vjeçare dhe 7 shkolla të mesme

1.2 Kuadri ligjor dhe kompetencat e Bashkisë në Arsim

Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor: Politikat kombëtare të arsimit parauniversitar kanë si synim:

- Sigurimin e një arsimimi gjithëpërfshirës, cilësor dhe të barabartë për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.
- Reduktimin e braktisjes shkollore.
- Përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të të mësuarit në të gjitha nivelet parauniversitare

Kuadri ligjor bazë për arsimin parauniversitar përfshin:

Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

- Përcakton strukturën dhe funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar: edukimi parashkollor, arsimi bazë dhe i mesëm i lartë.
- Thekson kompetencat e bashkive për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, financimin e kopshteve dhe sigurimin e transportit për nxënësit.

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar:

- Përcakton rolin dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore në administrimin e kopshteve dhe infrastrukturës arsimore në shkolla 9-vjeçare.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026:

- Parashikon ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës, cilësisë së mësimdhënies dhe uljen e pabarazive arsimore ndërmjet zonave urbane dhe rurale.

Vendime dhe udhëzime të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS):

- Mbi funksionimin e institucioneve parauniversitare, regjistrimin e nxënësve, organizimin e vitit shkollor, kurrikulat kombëtare etj.

2. Përmbledhje Ekzekutive

2.1 Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar

Qëllimi i këtij plani është të ofrojë një kuadër strategjik dhe operacional për zhvillimin e një sistemi arsimor parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në territorin e Bashkisë Divjakë.

Ky plan synon:

- Të evidentojë gjendjen aktuale të sistemit arsimor në nivel vendor dhe të analizojë nevojat ekzistuese.
- Të përcaktojë prioritetet dhe objektivat strategjike për përmirësimin e infrastrukturës arsimore, cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimit të shërbimeve arsimore për të gjitha grupmoshat parauniversitare.
- Të orientojë investimet dhe ndërhyrjet për krijimin e një mjedisi të sigurt, bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin arsimor dhe social të fëmijëve dhe të rinjve të Bashkisë Divjakë.
- Të kontribuojë në reduktimin e pabarazive arsimore ndërmjet zonave urbane dhe rurale, dhe të ndihmojë në përfshirjen më të mirë të fëmijëve në sistemin arsimor, duke parandaluar braktisjen shkollore.

Plani është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, strategjitë kombëtare për arsimin dhe objektivat zhvillimore të Bashkisë Divjakë për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Prioritetet kryesore

- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në të gjitha nivelet parauniversitare.
- Sigurimi i kushteve të barabarta për të gjithë nxënësit, veçanërisht në zonat rurale.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe profesionalizmit të stafit mësimor.
- Përmirësimi i shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe nxënësit (transporti, psikologë, mjekë shkolle, mjedise sportive).
- Reduktimi i braktisjes shkollore dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara në arsim.
- Nxitja e pjesëmarrjes komunitare dhe bashkëpunimit institucional për zhvillimin e arsimit parauniversitar.

2.2 Përmbledhje e strukturës dhe aktiviteteve të planit

Fusha e Arsimit Parashkollor:

- Rritja e numrit të kopshteve publike me standarde bashkëkohore.
- Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare dhe pajisjeve në kopshte.
- Sigurimi i stafit të kualifikuar për edukimin e hershëm.

Fusha e Arsimit Bazë:

- Rikonstruksioni dhe pajisja e shkollave 9-vjeçare me ambiente të përshtatshme për mësimdhënie.
- Organizimi i trajnimeve për mësuesit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.
- Ngritja e shërbimeve mbështetëse për nxënësit në nevojë dhe atyre me aftësi të kufizuara.
- Zbatimi i masave për parandalimin e braktisjes shkollore.

Fusha e Arsimit të Mesëm:

- Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e mesme të përgjithshme.
- Sigurimi i kushteve optimale për zhvillimin e arsimit profesional dhe orientimin e të rinjve drejt tregut të punës.
- Zhvillimi i aktiviteteve sociale, sportive dhe kulturore për të rinjtë e shkollave të mesme.

3. Analiza e shërbimit të arsimit parauniversitar

3.1 Arsimi parashkollor

Bazuar në të dhënat e Censurit 2023 dhe një analizë të trendit të grupmoshave, për vitin 2025 parashikohet që në Bashkinë Divjakë të jenë rreth 912 fëmijë të moshës 3–6 vjeç. Ky grup përbëhet nga:

- 3 vjeç: 217 fëmijë

- 4 vjeç: 217 fëmijë
- 5 vjeç: 239 fëmijë
- 6 vjeç: 239 fëmijë

Nga këta, aktualisht janë të regjistruar dhe ndjekin arsimin parashkollor **680 fëmijë**, që përbën rreth **74.6%** të kësaj grupmoshe. Kjo tregon një bazë të qëndrueshme për planifikimin e kapaciteteve në arsimin parashkollor dhe thekson rëndësinë e investimeve në infrastrukturë, staf dhe shërbime mbështetëse për këtë kategori.

Numri i fëmijëve të regjistruar në 32 kopshtet publike të Bashkisë Divjakë është 680, prej të cilëve **315 janë vajza**. Kjo tregon se numri i vajzave të regjistruara është pak më i ulët se ai i djemve.

Organizimi i fëmijëve bëhet në grupe të ndara sipas moshës dhe nevojave të zhvillimit:

Grupmosha	Numri i fëmijëve Vajza	
Grupi I (3–4 vjeç)	216	92
Grupi II (4–5 vjeç)	226	109
Grupi III (5–6 vjeç)	238	114
Totali	680	315

Ky ndarje ndihmon në përshtatjen e metodave të mësimdhënies sipas nivelit të zhvillimit dhe nevojave të fëmijëve.

Ndarja e Kopshteve sipas Zonave Urbane dhe Rurale

Në Bashkinë Divjakë funksionojnë gjithsej 32 kopshte, prej të cilave 1 kopsht ndodhet në zonën urbane (qytetin e Divjakës), ndërsa 31 kopshte ndodhen në zonat rurale të bashkisë.

Nga këto kopshte, vetëm dy ofrojnë shërbimin e drekës: njëri ndodhet në Divjakë (zona urbane) dhe tjetri në fshatin Çermë Sektor (një zonë rurale). 30 kopshte të tjera ofrojnë shërbim pa ushqim (pa drekë).

Kjo ndarje tregon një përqendrim të kufizuar të shërbimit të ushqimit në kopshte dhe një nevojë për përmirësim të kapaciteteve ushqyese, veçanërisht në zonat rurale.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon ndjeshëm në numrin e regjistrimit është përmirësimi i infrastrukturës së kopshtit si dhe ofrimi i ushqimit në kopsht. Sipas bashkisë kopshtet me ushqim, në mesin më vetë ose që janë rikonstruktuar së fundmi kanë numër më të lartë fëmijësh të regjistruar. Me kalimin e një kopshti nga pa drekë në kopsht me drekë, është vënë re që është rritur edhe numri i fëmijëve të regjistruar. E njëjta situatë vihet re edhe për kopshtet e rikonstruktura

Gjithashtu mund të theksojmë që vetëm në Kopshtin Divjakë ,Grabjan dhe Çermë Sektor kanë ndarje të plotë të fëmijëve sipas grupmoshave (Grupi I, II,III). Të gjitha kopshtet e tjera funksionojnë me grupe të përziera (fëmijët e moshave të ndryshme në të njëjtën klasë). Sipas të dhënave vihet re që numri i fëmijëve të regjistruar në grupet e përziera 58.8 %.

Raporti edukatore fëmijëve sipas normave ligjore

Grupmosha	Norma ligjore	Fëmijë gjithsej	Edukatorë të nevojshme
Grupi I (3-4 vjeç)	15 fëmijë	216	15
Grupi II (4-5 vjeç)	20 fëmijë	226	12
Grupi III (5-6 vjeç)	25 fëmijë	238	10
Totali		680	37

Aktualisht janë të punësuar 47 edukatore, duke rezultuar në një mbulim +10 më tepër se minimumi ligjor, çka garanton cilësi të mirë. Gjithashtu në Bashkinë Divjakë janë të punësuar edhe 8 edukatore për fëmijë me aftësi të kufizuar. Edukatorët punojnë në bashkëpunim me prindërit ,institucionet shëndetësore dhe shërbimet sociale të bashkisë për zbatimin e planeve individuale arsimore (PIA) për secilin prej këtyre fëmijëve.

Ky mbulim përfaqëson një angazhim të mirë të bashkisë në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shërbimet parashkollore publike.

Sfidat kryesore

Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme është një problem , pasi disa kopshte kerkojnë riparime dhe zgjerim për të siguruar kushte të mira mësimore dhe të qëndrueshme për fëmijët . Ulja e numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në këto grupe pasi pjesa më e madhe e kopshteve të bashkisë funksionon me grupe të përziera.

Mundësitë për përmirësim

Investimet në infrastrukturë , modernizimi dhe paisjet janë të domosdoshme për të krijuar ambiente sa më funksionale dhe të sigurta. Trajnimi dhe punësimi i stafit të specializuar do ndihmojë në përmirësimin e kujdesit për fëmijë me nevoja të veçanta . Fushatat ndërgjegjëse për prindrit do të rrisin pjesëmarrjen në arsimin parashkollor. Bashkëpunimi me komunitetin dhe institucionet lokale mund të ndihmojë në identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve që nuk frekuentojnë kopshtet.

3.2 Arsimi bazë

Bashkia Divjakë ka në juridiksionin e saj një rrjet të institucioneve arsimore të arsimit bazë, i cili përfshin shkollat 9-vjeçare të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Aktualisht, në bashki funksionojnë 17 institucione arsimore që ofrojnë arsimin bazë (9-vjeçar) të shpërndara në zona urbane dhe rurale të territorit. Këto institucione përbëhen nga:

- 11 shkolla 9-vjeçare të veçanta
- 6 shkolla të mesme të bashkuara, të cilat kanë në përbërje si ciklin 9-vjeçar, ashtu edhe arsimin e mesëm të lartë.

Tabela e mëposhtëme paraqet regjistrim të nxënësve për vitin shkollor 2024-2025 në arsimin bazë në Bashkinë Divjakë. Të dhënat përfshijnë 17 institucione arsimore dhe shtrihen nga klasa e parë deri në të nëntën.

Totali i Nxënësve sipas Klasave

Klasa	Nr. Nxënësve
Klasa 1	221
Klasa 2	261
Klasa 3	235
Klasa 4	251
Klasa 5	264
Klasa 6	274
Klasa 7	265
Klasa 8	252
Klasa 9	272

Totali i përgjithshëm i nxënësve në arsimin bazë (1-9): 2,295 nxënës.

Trendi i regjistrimeve tregon rritje progresive nga klasa e parë deri në të gjashtë, duke reflektuar përmirësim në përfshirjen në ciklin e lartë të arsimit bazë. Regjistrimet mbeten të larta edhe në klasat 7–9, çka tregon qëndrueshmëri në sistem.

Shkollat me më shumë nxënës:

- SHMB Çermë Sektor
- SHMB “Mihal Nako” Fierseman
- SHMB “Koli Allkanjari” Këmishtaj

Këto shkolla shërbejnë si qendra për zona më të gjera dhe kanë nevojë për më shumë burime njerëzore dhe infrastrukturore.

Shkollat me më pak nxënës:

- “Ismail Veizi” Babunjë, Miza, Sulëzotaj, Shënepremte dhe Spolatë

Këto shkolla përballen me sfida të mëdha për shkak të numrit të ulët të nxënësve dhe zhvendosjes demografike.

Gjendja aktuale e infrastrukturës dhe pajisjeve:

- **Godina të vjetruara**, veçanërisht në zonat rurale.
- Mungesë e **ambienteve sportive, rekreative dhe laboratorike**.
- Probleme me **infrastrukturën higjieno-sanitare**.
- Mungesë ambientesh për **fëmijë me aftësi të kufizuara**.

Pajisjet mësimore:

- **Kabinete informatike** (nevojë për përmirësim): Çermë Sektor, Grabian, “Koli Sako”
- **Laboratorë shkencorë**: “Miti Zoi Zaka”, “Koli Sako”, SHMB Çermë Shkumbin, SHMB Çermë Sektor

Godina problematike:

- “Miza & Babunjë”: shkolla të prishura, mësimi zhvillohet në ambiente të tjera
- “Koli Sako”: nevojë për riparim çatie
- “Gërmenj”: nevojë për rikonstrukcion të plotë
- SHMB Remas: kërkon përmbyllje investimi (aktualisht 70%)

Ambiente sportive ekzistuese:

- SHMB “Koli Allkanjari” Këmishtaj
- “Miti Zoi Zaka” Divjakë
- SHMB “Çermë Sektor”
- SHMB “Mihal Nako” Fierseman

Rekomandime strategjike:

Investime & Infrastrukturë:

- Përfundimi i investimeve në Remas
- Rikonstrukcion i plotë në Gërmenj
- Riparim çatie në “Koli Sako”
- Zhvendosje e nxënësve të Mizës dhe Babunjës në ambiente të sigurta

Pajisje & Teknologji:

- Kabinete informatike për shkollat pa pajisje
- Laboratorë për shkollat 9-vjeçare që nuk i kanë

Bashkëpunim Institucional:

- Koordinim me DAR Fier dhe programet rajonale
- Zhvillim programesh jashtëshkollore në 8 shkolla prioritare

Përgjegjësitë e Bashkisë Divjakë:

- Mirëmbajtje dhe rikonstrukcion i godinave
- Sigurimi i kushteve higjieno-sanitare
- Furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime
- Kujdes për oborret dhe ambientet e jashtme
- Shërbime psiko-sociale
- Investime për ambiente sportive dhe kabinete didaktike

Investimet prioritare duhet të përqendrohen në:

- Shkolla me numër të lartë nxënësish dhe godinë të amortizuar
- Përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare
- Krijimin e ambienteve për fëmijët me aftësi të kufizuara
- Sisteme ngrohjeje dhe ventilimi për kushte të përshtatshme gjatë dimrit

Rekomandim: Bashkia Divjakë duhet të hartojë një **plan investimesh afatmesëm dhe afatgjatë** bazuar në:

- Numrin e nxënësve
- Gjendjen e objekteve
- Mundësitë buxhetore dhe projektet në dispozicion

Sfidat kryesore:

- Përmirësimi i infrastrukturës
- Pajisje didaktike moderne
- Shërbime psiko-sociale
- Përfshirja e të gjithë fëmijëve në sistem

Mundësitë:

- Financime nga buxheti i bashkisë, qeveria qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë
- Aktivizimi i komunitetit dhe strukturave lokale

Përmbledhje gjinore dhe burime njerëzore për arsimin bazë: Bazuar në të dhënat e Censurit 2023, grupmosha 6–13 vjeç në Bashkinë Divjakë përbëhet nga rreth **2,572 fëmijë**, që përbën afërsisht **10.3%** të popullsisë së përgjithshme.

Sipas të dhënave të mbledhura nga shkollat për vitin shkollor 2024–2025, janë të regjistruar gjithsej **2,295 nxënës** në arsimin bazë (klasat 1–9), që përfaqësojnë **rreth 89.2%** të fëmijëve në këtë grupmoshë.

Nga këta:

- **1,480** janë vajza (**64.5%** e totalit),
- **815** janë meshkuj,
- **Numri i mësuesve** në arsimin bazë është **219**, duke krijuar një raport mesatar prej rreth **10.5 nxënës për mësues**.

Këto të dhëna sugjerojnë një përfshirje të mirë në sistemin arsimor për grupmoshën 6–13 vjeç, por gjithashtu evidentojnë një pabarazi gjinore në regjistrime në favor të vajzave. Kjo kërkon analiza të mëtejshme për të kuptuar shkaqet e pjesëmarrjes më të ulët të djemve, si dhe ndërhyrje të synuara për të siguruar barazi në aksesin dhe përfshirjen në arsim.

Popullsia potenciale (mosha 6–13 vjeç): Bazuar në të dhënat e Censurit 2023, Bashkia Divjakë ka rreth 2,572 fëmijë në grupmoshën 6–13 vjeç.

Regjistrimet aktuale në arsimin bazë

Sipas të dhënave të grumbulluara nga shkollat:

- Numri i nxënësve në klasat 1–9 është **2,295**.
- Vajza: rreth **1,480** ($\approx 64.5\%$)

3.3 Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Përmbledhje gjinore dhe burime njerëzore për arsimin e mesëm:

Bazuar në të dhënat e Censurit 2023, në Bashkinë Divjakë grupmosha 15–18 vjeç përbëhet nga rreth 1,073 të rinj. Kjo përfaqëson rreth 4.3% të popullsisë së përgjithshme.

Për vitin shkollor 2024–2025, janë të regjistruar gjithsej **653 nxënës** në arsimin e mesëm të lartë, nga të cilët:

- **405** janë vajza ($\approx 62\%$)
- **248** janë djem ($\approx 38\%$)

Numri i mësuesve në arsimin e mesëm është **74**, duke krijuar një raport mesatar prej rreth **8.8 nxënës për mësues**.

Sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe akteve nënligjore në fuqi, Bashkia Divjakë ka kompetenca të rëndësishme në fushën e arsimit parauniversitar, ku përfshihen edhe institucionet e arsimit të mesëm të përgjithshëm.

Funksionet kryesore janë:

- Mirëmbajtja, rikonstruksioni dhe ndërtimi i infrastrukturës shkollore
- Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore, përfshirë transportin e nxënësve, higjienën, sigurinë dhe pajisjet mësimore
- Promovimi i aktiviteteve jashtëmësimore, sociale, kulturore dhe sportive për të rinjtë
- Bashkëpunimi me institucionet arsimore për garantimin e kushteve të përshtatshme mësimore

Gjendja Aktualisht në Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm

Në territorin e Bashkisë Divjakë funksionojnë 7 shkolla të mesme të përgjithshme, nga të cilat:

- 6 shkolla janë të kombinuara me 9-vjeçare në të njëjtën godinë
- 1 shkollë është gjimnaz i dedikuar: Gjimnazi “Miti Zoi Zaka” në Divjakë.

Shënim: Të dhënat e mëposhtme paraqesin numrin e nxënësve vetëm për arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Emri i shkollës	Vendndodhja	Nr. Nxënësve (Arsimi Mesëm)
SHMB Çermë Sektor	Çermë Sektor	98

SHMB Çermë Shkumbin	Çermë Shkumbin	97
SHMB Mihal Nako	Fier-Seman	74
SHMB Grabjan	Grabjan	83
SHMB Koli Allkanjari	Kemishtaj	75
SHMB Remas	Remas	61
Gjimnazi Miti Zoi Zaka	Divjakë	236
Totali		724

Vlerësimi i sfidave kryesore:

- Infrastruktura e amortizuar
- Mungesë laboratorësh dhe pajisjesh
- Transport i pamjaftueshëm
- Shërbime sociale dhe mbështetëse të kufizuara
- Mungesë aktiviteteve jashtëmësimore

Mundësi për përmirësim

- Hartimi i një plani investimesh
- Sigurimi i një autobusi shkollor
- Investim në Gjimnazin “Miti Zoi Zaka”
- Aktivizim i programeve rinore dhe sportive
- Aplikim për fonde të huaja dhe kombëtare

Rekomadime prioritare

1. Hartimi dhe miratimi i një Plani Strategjik 3–5 vjeçar për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse.
2. Sigurimi i një autobusi shkollor për zonat me përqendrim të ulët nxënësish.
3. Investim në laboratorët shkencorë dhe kabinete informatike.
4. Krijimi i programeve jashtëshkollore ndërkollore.
5. Angazhimi i psikologëve dhe punonjësve socialë në të gjitha shkollat e mesme.
6. Hartimi i projekteve për aplikim në fondet IPA dhe MASR.

Këto masa synojnë përmirësimin e cilësisë së arsimit të mesëm në Bashkinë Divjakë dhe krijimin e kushteve të barabarta për arsimim cilësor për të gjithë të rinjtë.

4. Përfshirja e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimi Psiko-Social

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) në arsimin parauniversitar përbën një prioritet të rëndësishëm për Bashkinë Divjakë në kuadër të garantimit të arsimit gjithëpërfshirës, në

përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit dhe Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Gjatë vitit shkollor 2024–2025, në institucionet arsimore të Bashkisë Divjakë janë të përfshirë gjithsej 65 fëmijë me aftësi të kufizuara, të shpërndarë në tre nivele të arsimit parauniversitar: fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Tabela më poshtë përmbledh përfshirjen dhe mbështetjen e tyre me staf ndihmës:

Niveli Arsimor	Nr. Fëmijëve me AK	Nr. Mësuesve Mbështetës	Raporti Mësues:Fëmijë
Arsimi Fillor (AF)	28	24	1:1.17
Arsimi Mesëm i Ulët (AMU)	25	18	1:1.39
Arsimi Mesëm i Lartë (AML)	12	9	1:1.33

Në total janë të angazhuar 51 mësues ndihmës, nga të cilët:

- 22 janë me status të përhershëm (definitiv),
- 29 janë me kontrata të përkohshme.

Përveç mësuesve mbështetës, bashkia ka në funksion edhe një shërbim të dedikuar psiko-social, i cili përbëhet nga:

- 3 psikologë shkollorë, dhe
- 5 punonjës psiko-socialë.

Ky shërbim ndihmon në identifikimin e nevojave të veçanta të nxënësve, mbështetjen emocionale dhe sociale të tyre, si dhe ofrimin e ndërhyrjeve të përshtatura në bashkëpunim me mësuesit, edukatorët dhe prindërit. Shërbimi mbështet gjithashtu hartimin dhe ndjekjen e planeve individuale të zhvillimit (PIA) për çdo fëmijë me aftësi ndryshe.

Sfidat aktuale:

- Mungesa e mjeteve didaktike të përshtatshme për fëmijët me AK;
- Mungesa e infrastrukturës së aksesueshme në disa shkolla e kopshte;
- Mungesa e qëndrueshmërisë në punësimin e mësuesve mbështetës (për shkak të kontratave të përkohshme);
- Nevoja për zgjerim të shërbimit psiko-social, sidomos në shkollat më të mëdha.

Rekomandime:

- Fuqizimi i statusit të mësuesve mbështetës me kontratë për të garantuar qëndrueshmëri në ofrimin e mbështetjes;
- Rritja e numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla me popullsi të madhe nxënësish;
- Pajisja e shkollave me mjete të përshtatura mësimore dhe logjistike për fëmijët me AK;
- Ndërtimi ose përshtatja e mjediseve për akses të barabartë (rampe, tualete të posaçme etj.).

5. Qendra Kulturore e Fëmijëve – Strukturë Mbështetëse Jashtëkurrikulare

Qendra Kulturore e Fëmijëve në Divjakë është një strukturë publike e rëndësishme për edukimin jashtëkurrikular të fëmijëve dhe të rinjve. Ajo përbëhet nga tre sektorë kryesorë: arti, sporti dhe sektori tekno-shkencor. Në QKF janë të angazhuar gjithsej 5 instruktorë në fushat: muzikë, vizatim, futboll, kërcim dhe interpretim/krijimtari letrare.

5.1 Qëllimi, Misioni dhe Objektivat

Qëllimi: Të ofrojë një hapësirë kreative dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin artistik, kulturor dhe social të fëmijëve dhe të rinjve të Bashkisë Divjakë.

Misioni: QKF synon të edukojë, frymëzojë dhe fuqizojë fëmijët përmes veprimtarive artistike, kulturore dhe edukative, duke nxitur vlera qytetare, respekt për trashëgiminë dhe zhvillimin e talenteve.

Objektivat kryesore:

1. Zhvillimi i kurseve artistike dhe krijuese për fëmijët në moshë shkollore.
2. Organizimi i veprimtarive kulturore, sportive dhe festivaleve me karakter bashkëpunues.
3. Përfshirja e fëmijëve nga të gjitha shkollat dhe zonat e Bashkisë, me fokus në barazi dhe gjithëpërfshirje.
4. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet arsimore për ndërlidhjen mes arsimit formal dhe zhvillimit krijues.
5. Promovimi i identitetit kulturor lokal dhe vlerave kombëtare përmes artit dhe aktivitetit komunitar.

5.2 Kalendar i aktiviteteve të Qendrës Kulturore të Fëmijëve 2024–2025

Aktivitetet Kryesore

Muaji

Nëntor	Kampionat minifutbolli; Konkurs pikturë “Shqipëria Kuq e Zi”; Koncert festiv “Ty flamur të duam shumë”
Dhjetor	Konkurs pikturë “Festo Viti i Ri”; Kros dimëror; Koncert festiv “Ja na erdhi Viti i Ri”
Shkurt	Interpretim i fjalës artistike “Fjala Artistike”; Kampionat shahu “Shah–mat”
Mars	Koncert festiv për 7–8 Marsin; Konkurs pikturë; Lojëra popullore mes grupeve të QKF
Prill	Kampionat futbollit; Aktivitet folklorik “Harmonia Myzeqare”
Maj	Veprimtari sportive (atletikë); Konkurs “Talenti 2025” në këngë, interpretim dhe pikturë
Qershor	Koncert “1 Qershori”; Aktivitete “Gëzojmë dhe argëtohemi së bashku”; Ekspozitë vizatimesh dhe analizë vjetore

6. Objektivat dhe masat strategjike

6.1 Objektivat e përgjithshme

Objektivat strategjike që synon të arrijë Bashkia Divjakë në fushën e arsimit parauniversitar, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe vendore për një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për të gjithë.

Përmirësimi i strukturës menaxheriale dhe ofrimit të shërbimit

- Rritja e kapaciteteve të drejtuesve të institucioneve arsimore përmes trajnimeve të vazhdueshme.
- Forcimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së shkollave dhe kopshteve.
- Digjitalizimi i procesit të raportimit dhe menaxhimit të të dhënave arsimore.
- Ngritja dhe funksionalizimi i grupeve ndër-institucionale për bashkëpunim arsim-shëndet-social.

Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës dhe mjedisit të të nxëniet

- Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i ambienteve shkollore dhe parashkollore sipas standardeve.
- Sigurimi i ngrohjes, ndriçimit dhe kushteve higjieno-sanitare në çdo institucion arsimor.
- Krijimi i ambienteve të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Pajisja e shkollave me mjete mësimore dhe teknologji moderne.

Kritja e numrit të regjistrimeve dhe garantimi i gjithpërfshirjes

- Fushata ndërgjegjësuere për përfshirjen e fëmijëve 3–6 vjeç në institucionet parashkollore.
- Identifikimi dhe ndjekja e fëmijëve jashtë sistemit arsimor.
- Zhvillimi i politikave mbështetëse për regjistrimin dhe ndjekjen e rregullt të shkollës për fëmijët nga komunitetet vulnerabël.
- Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin për të rritur ndërveprimin shkollë–familje.

Përmirësimi i shërbimeve mbështetëse dhe cilësisë së mësimdhënies

- Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale në të gjitha shkollat dhe kopshtet përmes psikologëve dhe logopedëve.
- Trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe edukatorëve për qasje gjithëpërfshirëse dhe metodologji bashkëkohore.
- Krijimi i këndeve të zhvillimit psiko-social dhe sportiv në shkolla dhe kopshte.
- Fuqizimi i bibliotekave shkollore dhe këndeve të leximit për të nxitur shprehinë e të lexuarit.

6.2 Masat strategjike

Aktivitetet dhe masat konkrete që do të ndërmerren nga Bashkia Divjakë për realizimin e objektivave strategjike në fushën e arsimit parauniversitar. Aktivitetet synojnë përmirësimin e menaxhimit, infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta.

• Përmirësimi i strukturës menaxheriale dhe ofrimit të shërbimit

- Organizimi i trajnimeve për drejtuesit e shkollave dhe kopshteve mbi menaxhimin efektiv dhe lidërshpin arsimor.
- Zhvillimi i një sistemi digjital për raportimin e të dhënave arsimore në nivel bashkie.
- Hartimi dhe zbatimi i manualeve të qeverisjes së mirë në institucionet arsimore.
- Krijimi i një strukture monitoruese për ndjekjen e zbatimit të planit arsimor në nivel vendor.

• Përmirësimi i kushteve të infrastrukturës dhe mjedisit të të nxënit

- Hartimi i një vlerësimi të plotë të infrastrukturës së institucioneve arsimore ekzistuese.
- Prioritizimi i ndërhyrjeve për rikonstruksionin e ambienteve të amortizuara.

- Sigurimi i ngrohjes me eficiencë energjetike për të gjitha institucionet.
- Ndërtimi i këndeve të lojërave dhe ambienteve rekreative në kopshtet me hapësirë të përshtatshme.

- **Rritja e numrit të regjistrimeve dhe garantimi i gjithpërfshirjes**

- Fushata informuese dhe sensibilizuese në komunitet për rëndësinë e arsimit parashkollor dhe bazë.
- Bashkëpunim me strukturat vendore për identifikimin e fëmijëve që nuk ndjekin arsimin.
- Krijimi i një fondi të posaçëm për mbështetjen e fëmijëve nga familje në nevojë.
- Zhvillimi i takimeve të rregullta me prindërit për të nxitur përfshirjen e tyre në edukim.

- **Përmirësimi i shërbimeve mbështetëse dhe cilësisë së mësimdhënies**

- Angazhimi i psikologëve dhe logopedëve në institucionet arsimore me më shumë se 50 fëmijë.
- Trajnimi i edukatorëve dhe mësuesve në metodologji gjithpërfshirëse dhe teknika moderne të të nxënit.
- Pajisja e klasave me materiale të reja mësimore dhe didaktike.
- Organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore dhe kulturore për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijëve.

7. Planifikimi i Burimeve Financiare

Planifikimi i burimeve financiare është një komponent thelbësor për realizimin e objektivave të planit të arsimit bazë në Bashkinë Divjakë. Ai përfshin përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për mbulimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara dhe sigurimin e mjeteve për përmirësimin e kushteve të shkollave, shërbimeve mbështetëse, pajisjeve didaktike dhe kualifikimin e stafit arsimor e administrativ.

7.1 Burimet financiare vendore

Burimet financiare vendore përbëhen nga buxheti i Bashkisë, i cili planifikohet dhe miratohet çdo vit nga Këshilli Bashkiak. Këto fonde do të përdoren për:

- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së shkollave 9-vjeçare.
- Sigurimin e materialeve didaktike dhe teknologjisë bashkëkohore për mësimdhënie.
- Pagesën e shpenzimeve operative të institucioneve arsimore.
- Mbështetjen financiare për fëmijët me nevoja të veçanta dhe transportin e tyre, aty ku është e nevojshme.
- Organizimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive për nxënësit.

7.2 Burime financimi të tjera

Për të siguruar realizimin e plotë të planit dhe për të përballuar shpenzimet që nuk mbulohen nga buxheti vendor, është e rëndësishme të identifikohen dhe të shfrytëzohen edhe burime alternative financimi, si:

- Donacione nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.
- Mbështetje financiare dhe materiale nga institucione shtetërore të nivelit qendror.
- Mundësi bashkëfinancimi nga projekte të përbashkëta me donatorë dhe partnerë zhvillimi.
- Aplikime në programe të ndryshme mbështetëse që financojnë sektorin e arsimit.

7.3 Klasifikimi i burimeve sipas natyrës

Burimet njerëzore

Planifikimi i nevojave buxhetore për stafin arsimor dhe administrativ në arsimin parashkollor është thelbësor për garantimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve arsimore.

Rekrutimi i stafit

- Hartimi i profilit të edukatorëve, ndihmës-edukatorëve dhe punonjësve të shërbimit.
- Përcaktimi i numrit optimal të stafit në përputhje me standardet.
- Buxhetimi për pozicionet bosh dhe nevojat e reja.

Trajnimi dhe zhvillimi profesional

- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për edukatorët mbi kurrikulën, metodat moderne dhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Sigurimi i buxhetit për pjesëmarrjen në trajnime lokale e kombëtare.

Zhvillimi profesional i drejtuesve dhe stafit ndihmës

- Trajnime për menaxhimin institucional dhe monitorimin e cilësisë.
- Trajnime për stafin ndihmës mbi higjienën, sigurinë dhe kujdesin ndaj fëmijëve.

Monitorimi dhe vlerësimi i performancës

- Vendosja e një sistemi të rregullt për vlerësimin e punës së stafit.
- Lidhja e vlerësimit me nevojat për zhvillim profesional.

Burimet Materiale dhe Infrastrukturore

Për të siguruar kushte të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e fëmijëve, është e nevojshme të bëhet vlerësimi i situatës aktuale dhe planifikimi i investimeve në infrastrukturë dhe pajisje mësimore.

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

- Inspektimi i godinave, ambienteve, tualeteve, oborreve dhe pajisjeve ekzistuese.
- Hartimi i një harte nevojash për çdo institucion.

Investimet në infrastrukturë

- Buxhetimi për rikonstrukcion ose ndërtim të ri të ambienteve.
- Sigurimi i aksesit për fëmijët me aftësi ndryshe (rampe, tualete të përshtatshme).

Furnizimi me pajisje dhe mjete mësimore

- Mobilie për fëmijë 3-6 vjeç, lodra edukative, libra dhe materiale didaktike.
- Pajisje teknologjike për edukatorët (laptopë, projektorë, internet).

Menaxhimi i inventarit dhe mirëmbajtja

- Krijimi i një sistemi të mirëmbajtjes së rregullt.
- Mbajtja e një inventari të përditësuar për çdo institucion.

8. Aktivitete dhe planifikimi i zbatimit

8.1 Aktivitetet sipas Fushave Arsimore

Arsimi Parashkollor

- Rikonstrukcioni i kopshteve me infrastrukturë të dobët
- Rritja e numrit të kopshteve me ofrim ushqimi
- Ndërtimi i këndeve të lojërave në 5 njësi administrative
- Trajnime për edukatore në metodologji gjithëpërfshirëse
- Pajisje për fëmijët me aftësi ndryshe (mobilie, mjete didaktike)
- Fushata ndërgjegjësuese për regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç

Arsimi Bazë (9-vjeçar)

- Rikonstrukcioni i shkollave: Remas, Gërmenj, Babunjë, Miza
- Pajisje me laboratorë dhe kabinet informatike
- Trajnime për mësues në qasje gjithëpërfshirëse
- Angazhimi i psikologëve në shkollat me më shumë se 50 nxënës

- Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare
- Ofrimi i transportit për zonat me shpërndarje të ulët të nxënësve

Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

- Ndërtimi i palestrave në Çermë Sektor dhe Remas
- Investim në Gjimnazin "Miti Zoi Zaka"
- Pajisje me laboratorë dhe kabinete për shkollat e mesme
- Autobusë për transport nxënësish nga zona të largëta
- Programe jashtëmësimore (sociale, kulturore, sportive)
- Trajnime për mësues dhe drejtues të shkollave të mesme

8.2 Afatet e Zbatimit

Afatshkurtër (2025–2026)

- Rikonstruktionet urgjente në Babunjë, Miza
- Ndërtimi i këndeve të lojërave në 5 njësi
- Trajnime bazë për stafin arsimor
- Fillimi i pajisjes me mjete teknologjike

Afatmesëm (2026–2028)

- Laboratorë dhe kabinete në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme
- Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse (psikologë, logopedë)
- Autobusë për transportin e nxënësve
- Programe rinore dhe aktivitete jashtëshkollore

Afatgjatë (2029–2030)

- Përshtatja e infrastrukturës për fëmijët me aftësi ndryshe
- Konsolidimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit
- Reduktimi i braktisjes shkollore
- Rritja e cilësisë së arsimit dhe digjitalizimi i plotë

8.3 Roli i Aktorëve të Përfshirë

Aktori	Përgjegjësi
Bashkia Divjakë	Planifikim, financim, menaxhim i infrastrukturës dhe shërbimeve

Drejtuesit e shkollave	Zbatim dhe monitorim i aktiviteteve në nivel shkolle
Këshillat e shkollave	Përfaqësim komuniteti dhe mbështetje në vendimmarrje
DAR Fier	Mbështetje teknike dhe metodologjike
MASR	Hartim politikash, mbështetje për fonde qendrore
Komuniteti & OJF	Mbikëqyrje sociale, donacione, fushata ndërgjegjësimi
Donatorët	Financim infrastrukturor, trajnime, pajisje

8.4 Detajimi i Shpenzimeve dhe Burimet Financiare

Aktiviteti	Shuma (në lekë)	Burimi
Ndërtimi i shkollës “Ismail Veizi” Babunjë	15,795,530	T.S & T.P të pakushtëzuara
Rikonstruksion Remas + palestër	19,127,494	Transfera të pakushtëzuara
Kënde lodrash (5 njësi)	12,500,000	Transfera sektoriale të trashëguara
Pajisje kompjuterike	115,994	Transfera sektoriale
Ushqim për kopshte	4,287,177	Transfera sektoriale
Materiale didaktike dhe pastrimi	850,000	Transfera sektoriale
Shpërblime për nxënësit ekselentë	1,999,999	T.S & të ardhura vendore
Mbikëqyrje punimesh	2,240,857	T.P të trashëguara

9. Përmbledhje e investimeve kapitale

Tabelat më poshtë përmbledhin të gjitha projektet e planifikuara në Bashkinë Divjakë për vitin 2025, duke përfshirë furnizime për kopshtet dhe shkollat, rikonstruksione, pajisje teknologjike, dhe ndërtim kënde lojërash. Burimet e financimit janë të specifikuar për secilin projekt.

Programi 09120

Nr.	Përshkrimi i Projektit	Vlera (lekë)	Burimi i Financimit
1	Blerje materiale kancelarike	200,000	Transfera sektoriale (T.S 01)
2	Blerje ushqimesh për kopshtet me drekë	4,287,177	T.S 01 (2,000,000 + 2,287,177 nga të trashëguara)
3	Blerje materiale pastrimi dhe detergjent	250,000	Transfera sektoriale (T.S 01)

4	Blerje materiale bazë për kopshtet	400,000	Transfera sektoriale (T.S 01)
5	Blerje gazi	150,000	Transfera sektoriale (T.S 01)
6	Qira për kopshtet	500,000	Transfera sektoriale (T.S 01)
7	Energjia elektrike për kopshtet dhe shkollat	1,119,000	Transfera sektoriale (T.S 01)
8	Shpërblime për nxënësit ekselentë	700,000	Transfera sektoriale të trashëguara (T.S 01)
9	Të tjera shpenzime operacionale	638,313	Transfera sektoriale të trashëguara (T.S 01)
10	Mbikëqyrje për ndërtimin e shkollës “Ismail Veizi” – Babunjë	674,466	Transfera sektoriale (T.S 01)
11	Ndërtimi i shkollës “Ismail Veizi” – Babunjë	15,795,530	TS pakushtëzuar (5,691,059) + T.S 01 (5,104,471) + T.S pakushtëzuar trashëguar (5,000,000)
12	Blerje pajisje kompjuterike	115,994	Transfera sektoriale e trashëguar (T.S 01)
13	Përmirësim i këndit të lojërave – Njësia Administrative Divjakë	2,500,000	Transfera sektoriale e trashëguar (T.S 01)
14	Ndërtim këndi lodrash – Njësia Administrative Tërbuf (Cerme Sektor)	2,500,000	Transfera sektoriale e trashëguar (T.S 01)
15	Ndërtim këndi lodrash – Njësia Administrative Grabian (Grabjan)	2,500,000	Transfera sektoriale e trashëguar (T.S 01)
16	Ndërtim këndi lodrash – Njësia Administrative Gradishtë (Kemishtaj)	2,500,000	Transfera sektoriale e trashëguar (T.S 01)
17	Ndërtim këndi lodrash – Njësia Administrative Remas (Remas)	2,500,000	Transfera sektoriale e trashëguar (T.S 01)

Programi 09230

Nr.	Përshkrimi i Projektit	Vlera (lekë)	Burimi i Financimit
1	Blerje baze materiale të ndryshme	300,000	Transfera sektoriale (T.S 01) (212,599+87,401 Te ardhura vendore (05))
2	Te tjera shpenzime	737,000	Të Ardhura Vendore
3	Kolaudim punimesh per objektin Rikonstruuar I objekteve egzistuese shtese anesore dhe ndertim palestrene Shkollen e bashkuar Remas	120,000	Transfera e pakushtëzuar (T.P 01) të trashëguara
4	Mbikqyrje punimesh: ndertim palestere te mbuluar dhe rikonstruksion i shkolles së mesme te bashkuar Çermë Sektor	734,634	Të Ardhurat vendore (05) (146,927+587,707 transferte e pakushtëzuar (T.P 01))
5	Rikonstruksion i objekteve egzistuese shtese anesore dhe ndertim palestere ne Shkollen e Bashkuar Remas	19,127,494	Transfera e pakushteziuar (TP 01) te trasheguara.
6	Ndertim Palestre e mbuluar dhe rikonstruksion i Shkolles te mesme te bashkuar Çërme Sektor	500	Transfera e pakushteziuar (TP 01) te trasheguara
7	Mbikqyrje punimesh: per objektin Rikonstruksion i objekteve ekzistuese shtese anesore dhe ndertim palestere ne Shkollen e Bashkuar Remas	831,757	Transfera e pakushteziuar (TP 01) te trasheguara
8	Shpërblime për nxënësit ekselentë	1,299,999	Transfera sektoriale të trashëguara (TS 01) (622,477+677,522 te ardhuar vendore te trasheguara)

Programi 09120- Projektet dhe Burimet e Financimit (2026–2028)

Nr.	Përshkrimi i Projektit	Vlera e Planifikuar (lekë)	Burimi i Financimit
1	Blerje ushqimesh për kopshtet me drekë	4,287,177	T.S 01 + të ardhura të trashëguara
2	Blerje materiale pastrimi dhe detergjent	250,000	T.S 01
3	Blerje materiale kancelarie	200,000	T.S 01
4	Blerje materiale bazë për kopshtet	400,000	T.S 01
5	Blerje gazi	150,000	T.S 01
6	Qira për kopshtet	500,000	T.S 01
7	Energji elektrike për kopshtet dhe shkollat	1,119,000	T.S 01
8	Shpërblime për nxënësit ekselentë	700,000	T.S trashëguara
9	Të tjera shpenzime operacionale	638,313	T.S trashëguara
10	Blerje kamera sigurie për kopshtin Çermë Sektor	1,000,000	Të ardhura vendore
11	Investim për t'u planifikuar në vitin 2026	1,478,981	Transferte sektoriale
12	Investim për t'u planifikuar në vitin 2027	2,478,981	Transferte sektoriale
13	Investim për t'u planifikuar në vitin 2028	2,478,981	Transferte sektoriale

Programi 09230 – Projekte të dedikuara (2026–2028)

Nr.	Përshkrimi i Projektit	Vlera e Planifikuar (lekë)	Burimi i Financimit
1	Blerje bazë materiale të ndryshme	212,599	Transferte sektoriale
2	Mbikëqyrje punimesh për ndërtim palestër të mbuluar dhe rikonstruksion i shkollës Çermë Sektor	446,644	Transferte e pakushtëzuar

10. Monitorimi dhe Vlerësimi

Indikatorët e matshëm në arsim janë tregues sasiore apo cilësorë që përdoren për të matur, vlerësuar dhe krahasuar arritjet, cilësinë dhe efikasitetin e sistemit arsimor, institucioneve arsimore, programeve apo proceseve mësimore. Ata ndihmojnë për të përcaktuar nëse objektivat e vendosura janë arritur dhe për të identifikuar fusha që kërkojnë përmirësim.

10.1 Indikatorët e Matshëm të Performancës

Indikatorët e Matshëm të Performancës në Arsimin Parashkollor

Indikator	Përshkrimi	Njësia e Matjes	Vlera aktuale / Komete
Përqindja e fëmijëve të regjistruar në kopshte	Numri i fëmijëve të regjistruar ndaj popullsisë 3–6 vjeç	%	680 nga 912 fëmijë (\approx 74.6%)
Raporti edukator–fëmijë	Mesatarja e fëmijëve për çdo edukatore	Numër	680 fëmijë / 47 edukatore \approx 14.5
Përqindja e grupeve të ndara sipas moshës	Kopshte që kanë ndarje sipas grupmoshës I, II, III	%	Vetëm 3 kopshte nga 32 (\approx 9.3%)
Përqindja e kopshteve me shërbim ushqimor	Kopshte që ofrojnë drekë për fëmijët	%	2 nga 32 kopshte (\approx 6.25%)
Përqindja e kopshteve me grupe të përziera	Kopshte ku moshat janë të kombinuara në një klasë	%	58.8% e fëmijëve ndjekin grupe të përziera
Edukatore për fëmijë me aftësi të kufizuara	Edukatore për fëmijë me aftësi të kufizuara ndaj totalit	%	8 nga 47 edukatore (\approx 17%)
Pjesëmarrja gjinore	Raporti vajza/djem në regjistrim	Raport	315 vajza / 680 fëmijë (\approx 46.3%)

Indikatorët e Matshëm të Performancës në Arsimin Bazë (9-vjeçar)

Indikator	Përshkrimi	Njësia e Matjes	Vlera aktuale / Komete
Numri total i nxënësve të regjistruar	Nxënësit e klasës 1–9 në vitin shkollor 2024–2025	Numër	2,295 nxënës
Raporti nxënës për mësues	Mesatarja e nxënësve për çdo mësues në shkollat 9-vjeçare	Numër	2295 nxënës / 219 mësues \approx 10.5

Braktisja shkollore	Përqindja e nxënësve që ndërpresin shkollimin para klasës së 9-të	%	Të dhëna të paplota – kërkohet matje vjetore
Shkolla me laboratorë funksionalë	Numri i shkollave me laboratorë të pajisur	Numër	4 shkolla
Kabinete informatike	Shkolla të pajisura me IT për mësim	Numër	3 shkolla
Shkolla me infrastrukturë të dëmtuar	Numri i godinave që kërkojnë rikonstrukcion të plotë	Numër	Të paktën 4 shkolla
Pjesëmarrja në ciklin e lartë (klasat 7–9)	Ruajtja e numrit të nxënësve në ciklin e dytë	%	Rreth 265–272 nxënës për klasë – qëndrueshmëri
Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara	Shkolla me ambiente të përshtatura për AK	% / Numër	Të kufizuara – rekomandohet përmirësim

Indikatorët e Matshëm të Performancës në Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm

Indikator	Përshkrimi	Njësia e Matjes	Vlera aktuale / Komente
Numri total i nxënësve të regjistruar	Nxënësit e regjistruar në 7 shkolla të mesme	Numër	724 nxënës
Raporti vajza–djem në regjistrim	Raporti gjinor	Raport	405 vajza / 248 djem ≈ 62% vajza
Numri i mësuesve	Numri i stafit mësimor	Numër	74 mësues
Raporti nxënës–mësues	Mesatarja e nxënësve për çdo mësues	Numër	≈ 8.8 nxënës për mësues
Shkolla me laboratorë shkencorë	Numri i shkollave të mesme me laboratorë shkencorë	Numër	Vetëm disa të pajisura – nevojë për investime
Kabinete informatike	Shkolla me pajisje IT	Numër	Pjesërisht të pajisura
Shkolla me ambiente sportive	Gjimnaze me palestër funksionale	Numër	4 shkolla kanë palestra
Braktisja në gjimnaz	Nxënës që largohen para përfundimit të klasës së 12-të	%	Problematikë e mundshme – kërkohet monitorim
Transporti i nxënësve	Nxënës që marrin mbështetje për transport	% / Numër	I kufizuar – kërkohet blerje autobusi
Shërbime mbështetëse (psikolog/social)	Përqindja e shkollave me staf mbështetës	%	E kufizuar – kërkohet zgjerim

Aktivitete jashtëmësimore	Numri i shkollave me programe sociale, kulturore	Numër	Pjesërisht të aplikuara – nevojitet zgjerim
---------------------------	--	-------	---

10.2 Planifikimi i vlerësimit të progresit

- Vendosja e mekanizmave të qartë për matjen e progresit të zbatimit të planit dhe ndikimin që ka në zhvillimin e arsimit në Bashkinë Divjakë.
- Këto mekanizma përfshijnë përdorimin e indikatorëve të matshëm, krahasime me periudha të mëparshme dhe analizat e ndryshimeve.
- Analiza periodike e rezultateve të arritura sipas indikatorëve të performancës për të identifikuar përmirësime ose devijime.
- Vlerësimi i përmirësimeve në cilësinë e mësimdhënies (p.sh. anketat për mësuesit/nxënësit), efikasitetin e shërbimeve mbështetëse (transport, siguri, mbështetje psiko-sociale), dhe gjendjen e infrastrukturës përmes inspektimeve vjetore.

10.3 Mekanizmat konkretë për monitorim përfshijnë

- Raporte tremujore dhe vjetore të progresit
- Formulare standarde raportimi për shkollat
- Sisteme digjitale për mbledhje dhe analizë të të dhënave
- Inspektime në terren nga zyrtarë vendorë
- Anketa të rregullta me komunitetin dhe aktorët arsimorë

10.4 Përfshirja e aktorëve të jashtëm

- Konsultime të rregullta me ekspertë të arsimit, përfaqësues të DAR Fier, partnerë ndërkombëtarë dhe organizata vendore.
- Sigurimi i vlerësimeve të pavarura për të nxjerrë rekomandime konkrete dhe për të ruajtur objektivitetin në vlerësim.

11. Rishikimi dhe Përshtatja e Planit

Plani i Arsimit Parauniversitar i Bashkisë Divjakë 2025–2030 është një dokument strategjik dinamik, i cili do t'i nënshtrohet rishikimeve periodike për të siguruar koherencë me nevojat në terren dhe zhvillimet e reja në sektorin arsimor.

11.1 Procesi i rishikimit

Rishikimi do të realizohet:

Çdo dy vite (2027 dhe 2029), ose më shpesh nëse ka ndryshime madhore në nivel kombëtar apo vendor;

Nga një grup pune i përbashkët, përbërë nga përfaqësues të Bashkisë, Drejtorisë Arsimore Vendore, shkollave, komunitetit prindëror dhe OJF-ve partnere.

Procesi përfshin:

Mbledhje të dhënash statistikore dhe të performancës nga institucionet arsimore;

Vlerësim të progresit të objektivave dhe matje të treguesve të performancës;

Konsultim me aktorët lokalë për identifikimin e nevojave ose sfidave të reja;

Përditësim të objektivave dhe masave sipas zhvillimeve të reja;

Miratim dhe publikim të versionit të përditësuar të planit nga Këshilli Bashkiak.

Rezultatet e rishikimit:

Do të dokumentohen në një raport të veçantë;

Raporti do të publikohet dhe shpërndahet në kanale zyrtare;

Versioni i përditësuar hyn në fuqi pas miratimit institucional.

11.2 Përshtatja në bazë të të dhënave të reja

Për të siguruar që plani të mbetet i përputhshëm me realitetin dhe nevojat në zhvillim, Bashkia Divjakë angazhohet për përshtatje të vazhdueshme, bazuar në të dhëna të përditësuara dhe analiza objektive.

Burimet e të dhënave për përshtatje përfshijnë:

statistikat e regjistrimit dhe frekuentimit në arsim;

ndryshimet demografike sipas zonave;

kapacitetet infrastrukturore dhe stafi arsimor;

rezultatet arsimore të nxënësve dhe indikatorët e përfshirjes sociale.

Çdo përshtatje do të shoqërohet me një analizë ndikimi, të dokumentuar dhe publikuar në mënyrë transparente për komunitetin.

12. Raportimi dhe transparenca

12.1 Raportimi i progresit

Çdo vit do të hartohet një raport vjetor i monitorimit, që përfshin:

- shkallën e zbatimit të objektivave dhe masave të planit,
- të dhënat mbi përfshirjen, performancën, infrastrukturën dhe stafin arsimor,
- analiza të sfidave dhe masave korrigjuese të ndërmarra.

Raporti do të publikohet në:

- faqen zyrtare të Bashkisë Divjakë,

- platformën e transparencës së njësive vendore,
- dhe do të shpërndahet pranë drejtorive arsimore dhe institucioneve arsimore përkatëse.

12.2 Përfshirja e publikut

Për çdo fazë të rëndësishme të zbatimit ose rishikimit të planit, Bashkia angazhohet të:

- zhvillojë konsultime publike me komunitetin, sidomos me përfaqësues të shkollave, prindërve, mësuesve dhe organizatave të shoqërisë civile;
- përfshijë sugjerimet e komunitetit në versionet e përditësuara të planit, aty ku është e arsyeshme;
- ofrojë mënyra të qarta për dorëzimin e komenteve (në zyrë, online, gjatë dëgjësave publike).

Anekse

- **Të dhëna demografike dhe statistikore (Censusi 2023)**

- Popullsia totale e Bashkisë Divjakë sipas Censit 2023, e ndarë sipas gjinive dhe moshave;
- Ndarja e popullsisë 0–18 vjeç sipas grupmoshave: 0–3, 3–6, 6–14 dhe 15–18 vjeç;
- Përqindja e popullsisë në moshë shkollare në raport me totalin;
- Shpërndarja geografike e fëmijëve në njësi administrative për analizë territoriale të nevojave arsimore.

- **Lista e institucioneve arsimore në Bashki**

- Emrat e të gjitha institucioneve arsimore në territor (kopshte, shkolla 9-vjeçare, shkolla të mesme);
- Niveli i ofruar nga çdo institucion;
- Vendndodhja (njësia administrative dhe fshati/qyteti përkatës);
- Statusi i funksionimit (aktiv, i pezulluar përkohësisht, në rikonstruksion);
- Informacion mbi ofrimin e shërbimit me turne, me drekë etj.

- **Indikatorët e performancës dhe mekanizmat e matjes**

- Lista e indikatorëve kryesorë për monitorimin e cilësisë së arsimit (frekuentimi, përqindja e kalueshmërisë, përfshirja e fëmijëve me AK, etj.);
- Tregues të inputeve (raporti mësues-nxënës, gjendja e infrastrukturës);
- Tregues të proceseve dhe të rezultateve të të nxënit;
- Metodologjia e grumbullimit dhe analizimit të të dhënave.

- **Plani i detajuar i investimeve dhe burimet financiare**

- Investimet e planifikuara për ndërtim, rikonstrukcion, mobilim dhe teknologji arsimore;
- Ndarja e buxhetit sipas burimeve financiare:
 - Grantet e qeverisë,
 - Të ardhura vendore,
 - Donatorë dhe partnerë të jashtëm;
- Afatet kohore për realizimin e investimeve dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin.

- **Lista e aktorëve të përfshirë dhe rolet e tyre**

- Institucionet publike të përfshira (Bashkia, DRAP, shkollat, strukturat psiko-sociale);
- Shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare të angazhuara në arsim dhe të drejtat e fëmijëve;
- Strukturat e prindërve dhe këshillat e shkollave si pjesë e përfshirjes komunitare;
- Roli dhe përgjegjësitë e secilit aktor në fazat e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

- **Procesverbalet dhe rezultatet e konsultimeve publike**

- Përmbledhje e takimeve me grupet e interesit (drejtues shkollash, edukatorë, prindër, OJF);
- Sugjerimet e marra dhe reflektimi i tyre në përmbajtjen përfundimtare të planit;
- Dokumentet mbështetëse: lista e pjesëmarrësve, axhendat e takimeve, fotografi apo vlerësime të mbledhura në terren.